



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2083/8 Prot.

Durrës, më 6.11.2024

VENDIM

Nr. 24, datë 6.11.2024

PËR  
"PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË  
PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E VEPRIMTARISË DHE MARRDHËNIEVE  
ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"; Statutit të UAMD-së, neni 23; Rregullores së UAMD-së, neni 17 pika 3; Vendimit të Senatit Akademik nr. 63, datë 06.11.2023 "Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"; të shkresës nr. 2071 prot., datë 5.11.2024 mbi plotësimin e vendit vakant për anëtare të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Senati Akademik në mbledhjen e datës 6.11.2024,

VENDOSI:

1. Plotësimin e vendit vakant për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrdhënieve me Studentët Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, me studentin në rend zbritës, Daniel Kalari nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
  - Administratori
  - Zv. Rektorët
  - Drejtuesit e Njësive Kryesore
  - Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë së Marrdhënieve me Studentët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





*[Handwritten signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHËRBIMEVE AKADEMIKE

Nr. 2071/prot

Durrës, më 5.11.2024

**Lënda:** Relacion mbi plotësimin e vendit vakant për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

**PROF.DR. SHKËLQIM FORTUZI, KRYETAR**

**SENTATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

*I nderuar,*

Në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik me nr. 63, datë 06.11.2023 "Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", në vijim të shkresës së Kryetares së Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD, Dr. Dorina Gjipali, me nr. 1934 prot., datë 22.10.2024 "Mbi përfundimin e statusit të Elsa Rrustaj." dhe shkresës së Sektorit të Koordinimit në Rektorat me nr. 1934/1 prot., datë 23.10.2024 mbi "Plotësimin e vendit vakant për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.", ju informojmë se, Elsa Rrustaj, studente e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, e diplomuar në vitin akademik 2023-2024, ka përfunduar ciklin e studimeve të saj akademike.

Komisioni i Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD përbëhet gjithsej nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) anëtarë janë pjesë e stafit akademik të universitetit dhe 2 (dy) anëtarë janë përfaqësues të studentëve, për këtë arsye, si rrjedhojë e përfundimit të statusit të studentit për znj. Elsa Rrustaj, vendi i saj si anëtare e këtij Komisioni mbetet vakant.

Bazuar në Rregulloren e UAMD-së, neni 17 pika 3 ku citohet se "Përbërja e komisioneve të përhershme përcaktohet nga Senati Akademik. Në çdo rast një anëtar i personelit akademik mund



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHËRBIMEVE AKADEMIKE

*të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar i personelit akademik. Një anëtar student mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar student.*", propozohet që në vendin vakant si anëtar i përfaqësuesve të studentëve në këtë Komision, të jetë një nga kandidatët në rend pasardhës për këtë proces zgjedhor.

Për sa më sipër i propozojmë Senatit Akademik që, kandidati që përmbush kriteret e sipërcituara për vendin vakant për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, është studenti Danjel Kalari, aktualisht i regjistruar për vitin akademik 2024-2025, në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në "Shkenca Kompjuterike të Aplikuara" pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Ina Lushka